REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 52/2024 (JR)
Nr. 52/2 regj.

Tiranë, më 17.12.2025

**SHPALLJE**
**E**
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrës në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e martë, më datë 13.01.2026, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër (JR) 52/2024, datë 16.12.2024, që i përket ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit **Tonin Sterkaj**, kundër vendimit nr. 795, datë 04.09.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesuese e Trupit Gjykues** | **Rezarta Schuetz** |
| **Relator i Çështjes** | **Sokol Çomo** |
| **Gjyqtare** | **Albana Shtylla** |
| **Gjyqtare** | **Mimoza Tasi** |
| **Gjyqtare** | **Natasha Mulaj** |

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**
**GJYQTARE**
**REZARTA SCHUETZ**